



Norwegian Embassy



EKO SHKOLLËN

PËRMBAJTJA

Njoftim me EKO SHKOLLËN

- Intervistë "Problemi i shpyllëzimit në Kosovë"
- Si ta ngrisim vetëdijen qytetare për mbrojtjen e mjedisit
- Fakte alarmante!



Mbi EKO SHKOLLËN

I/e dashur lexues/e,

Po e fillojmë këtë buletin të ri. Ky do të jetë numri i parë i këtij formati informativ që do të përmbajë mesazhe, intervista dhe njoftime mbi ambientin dhe punën që po zhvillohet nga Klubi i Mjedisit "Luciano Motroni" dhe EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit EKO Shkolla.


Në kuadër të këtij projekti ofrohet një model dhe metodologji që përdoret gjërësisht në vendet e zhvilluara, por që po zgjerohet me shpejtësi edhe në vendet në zhvillim. Përvojat botërore tregojnë se shkolla ekologjike është një fenomen në rritje, i cili nxit të rinjtë të angazhohen në mjedisin e tyre duke u dhënë atyre mundësinë për ta mbrojtur atë në mënyrë aktive.

Përmes projektit ofrohet mundësia që nxënësit dhe mësimdhënësit e shkollës së përzgjedhur të bëhen pjesë e një programi afatgjatë që përban trajnime, aktivizëm, zbatim nismash dhe promovim mjedor. Përfitimet teje të rëndësishme që ka shkolla ekologjike janë raportet e vlerësimit të energjisë së eficiencës dhe udhëzuesit përmes ekspertë të angazhuar.

Në bazë të këtyre vlerësimeve shkolla përfiton intervenime direkte në hapësirën e saj, si një tentim tjetër përmes shndërruar atë në një ndërtësë ekologjike. EKO Shkolla është një fenomen në rritje, i cili inkurajon të rinjtë që të angazhohen në mjedisin e tyre duke u lejuar atyre mundësinë përmes mbrojtur atë në mënyrë aktive. Fillon në klasë, zgjerohet në shkollë dhe përfundimisht nxit ndryshimin në komunitetin e gjerë. Përmes këtij programi, të rinjtë përfjetojnë një ndjenjë arritjeje përmes qenës së gjendje të jashtëzakonishta e tyre në politikat e menaxhimit mjedor të shkollave të tyre. Programi i EKO Shkollës është një mënyrë ideale përmes shkollat që të ndërmarrin një rrugë domethënëse drejt përmirësimit të mjedisit si në shkollë ashtu edhe në komunitetin lokal, ndërkohë që në të njëjtën kohë ka një ndikim pozitiv në jetën e të rinjve, familjeve të tyre, stafi shkollor dhe autoritetet lokale. EC ka themeluar Klubin e Ambientit të cilët tashmë janë duke u mbështetur drejt pavarësimit të tyre në dhënier e kontributit përmes mbrojtjen e ambientit dhe përhapjes së metodologjisë së aplikuar drejt komunitetit të gjerë dëshmorëve të shkollave tjera.



Intervistë me ekologun prof.Dr.Asoc. Elez Krasniqi



1. Si qëndrojnë pyjet e Kosovës në rapport me problemen e shpyllëzimit?
 - Pyjet e Kosovës në rapport me problemen shpyllëzimin pasqyrohen mjaft keq. Kjo vjen kryesisht si rezultat i veprimit negativ antropogen.
2. Cilat institucione shtetërore janë përgjegjëse përmes menaxhimin dhe mbrojtjen e pyjeve?
 - Përmes menaxhimin e pyjeve është përgjegjës MBPZHR (në disa raste në bashkëpunim me MMPh).
3. Sa janë të mbrojtura pyjet nga institucionet? A ka përparim në fushën e mbrojtjes nga shpyllëzimi?
 - Në aspektin juridik, në bazë të legjislacionit janë të mbrojtura mjaft mirë, ndërsa praktikisht jo sa duhet. Ka përparime në këtë drejtim, mirpo jo në masën e duhur.
4. Si ndikon shpyllëzimi në humbjen e specieve dhe ç'rregullimin e ciklit jetësor?
 - Shpyllëzimi ndikon negativisht në humbjen e individëve të llojeve të caktuara apo edhe degradimit të habitateve të tyre.
5. Cilat do të duhej të ishin veprimet e institucioneve përkatëse përmes trajtimit e këtij problemi?
 - Ky është një problem i cili kërkon trajtim serioz. Ky problem duhet të trajtohet në radhë të parë në suaza të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit të Kosovës. Pastaj me programe specifike fillimisht përmes vetëdijesimit të mirfilltë (duke punuar me tërë shtresat e shoqërisë) të vazhdohet në dobi të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit ndërsa njëkohësisht duke e implementuar me intenzitet të vazhdueshëm në ngritje e sipër implementimin e dispozitave ligjore.

Aktivitetet e EKO Shkollës

Si ta ngrisim vetëdijen qytetare për mbrojtjen e mjedisit ?

Natyra është shtëpia jonë e përbashkët. Është vendi ku për mijëvjeqarë me radhë ka ekzistuar cikli i jetës, të cilin njeriu po e rrezikon sot me veprat e tij. Veprat e shumta dhe zhvillimet e pakontrolluara në raport me mjedisin janë duke krijuar pasoja të mëdha dhe efekte të pakthyeshme, pasoja të cilat po fillojmë t'i ndiejmë që tani. Djegia e qymyrit, emetimet e gazrave, kontaminimi i ujit, shpërthimet kimike, makinat e vjetra, shpyllëzimi, mosmenaxhimi i mbeturinave etj, janë vetëm disa nga veprimtaritë tona që po e shkatërrojnë habitatin tonë duke krijuar një pasiguri të madhe për gjeneratat e ardhshme.

Ka rëndësi të dihet një strategji e cila duhet të ndiqet për të evitar një krizë ekologjike në vendin tonë. Prioritetet duhet të janë problemet më të mëdha e më të ngutshme për tu zbatuar, që të sigurojnë një natyrë e mjedis të pastër. Ne besojmë se është detyrë e jona e përbashkët që t'a mbrojmë ambientin dhe rrëthinën ku jetojmë dhe rritemi ne.

Bashkë me organizatën EC Ma Ndryshe, ne si Klub i Ambientit nga shkolla "Luciano Motroni" kemi nisur aksione afatgjate me të cilat duam t'a ngrisim vetëdijen e gjithmbarshme qytetare për rëndësinë e ambientit dhe rrëthinës tonë, si dhe të nxism aktivizëm qytetarë për ruajtjen e mjedisit. Aksione të pastrimit, kampanja vetëdijesuese, shënimë të ditëve ndërkombëtare të mjedisit, seri të edukimit mjedisor, punëtori vizionuese për transformimin e hapësirave publike dhe debate publike janë disa nga aktivitetet tona si Klub të cilat i kemi realizuar në bashkëpunim me EC-in për të përcuar mesazhin e kauzës sonë dhe ngritur vetëdijen qytetare për një ambient të pastër dhe të gjelbër.

Blerim Selmani, Klubi Ambientit "Luciano Motroni"

Fakte alarmante !

1. 75% e insekteve janë zhdukur në 30 vitet e fundit




2. Pa insekte, 80% të frutave dhe perimeve do të zhdukeshin




3. 55% e kafshëve të egra janë zhdukur në 40 vitet e fundit




4. 95% e jetës në dhe do të vdesë në 60 vite




5. 90% e balenave dhe peshkaqenëve janë zhdukur




6. Shkalla e zhdukjes së specieve është rritur për 1000 herë



7. Oqeanet do të mbesin pa peshq në vitin 2048



8. 50% e oksigjenit vjen nga fitoplanktoni i cili është i rrezikuar në oqeanë



9. Mbipeshkimi mbyt 950 bilion peshq çdo vit



10. 475 bilion peshk i ngordhur dhe i paperdorshëm



11. 90% e farës së shitur është hibrid i selektuar



12. 60% e zonave bujqësore përdoren për të ushqyer bagëtinë



13. 15.500 litra ujë përdoren për të prodhuar 1kg mish



14. 60 billion kafshë mbyten çdo vit për konsum njerëzor



15. Speciet endemike të bimëve kanë humbur 70% të habitatit të tyre



16. Çdo vit, njerëzit marrin 25% të prodhimit bimor në botë



3

Klubi i Ambientit "Luciano Motroni"
Mehmet Pashë Devalla, 20000 Prizren

EC MA NDRYSHE

Adresa: Fehmi Lladrovci 94, 20000 Prizren
Bulevardi Nënë Tereza, H 30 B1 Nr. 5, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 38 224 967 & +381 29 222 771
Email: info@ecmandryshe.org
Web: www.ecmandryshe.org:
Social media:
<https://www.facebook.com/ecmandryshe>
<https://twitter.com/ecmandryshe>
<http://instagram.com/ecmandryshe>

Ky grant është mundësuar nga 'Programi i shoqërisë civile për Shqipërinë dhe Kosovën', financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA). Përbajtja dhe rekomandimet e paraqitura nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtar të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).

